

**JU OSE FËMIJA JUAJ MUND TË PREKEN NGA NJË MARRËVESHJE E PROPOZUAR
NË NJË PADI KOLEKTIVE QË LIDHET ME KUJDESIN PËR DIABETIN NË
SHKOLLAT PUBLIKE TË DEPARTAMENTIT TË ARSIMIT TË NJU JORKUT (NEW
YORK CITY DEPARTMENT OF EDUCATION)**

Ky njoftim është autorizuar nga një gjykatë. Ky nuk është një reklamim nga një avokat.

Fëmija juaj mund të jetë anëtar i një klase të propozuar për Marrëveshjen nëse ai/ajo:

- a) kanë diabet të Tipit 1 ose Tipit 2; dhe**
- b) është aktualisht ose do të regjistrohet në të ardhmen në një shkollë publike të Departamentit të Arsimit të Nju Jorkut (DOE).**

Në vitin 2018, tre fëmijë me diabet, përmes prindërve të tyre, së bashku me Shoqatën Amerikane të Diabetit (American Diabetes Association) (së bashku, Paditësit në Fjalë), ngritën një padi kundër të Paditurve (DOE, Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës Mendore të Qytetit të Nju Jorkut (New York City Department of Health and Mental Hygiene), Zyra e Shëndetit në Shkolla (Office of School Health), dhe Qyteti i Nju Jorkut), duke kërkuar kujdes më të mirë për fëmijët me diabet në shkollë. Ky proces gjyqësor quhet *M.F., et al. v. kundër Departamentit të Arsimit të Nju Jorkut (New York City Department of Education), et al.*, Civil No. 18-CV-6109.

Në vitin 2022, të Paditurit ranë dakord për një Marrëveshje duke pranuar të vendosin në zbatim disa rregullore, praktika dhe procedura. Si përmbledhje, Marrëveshja parashikon: 1) përmirësimin e planifikimit për nxënësit me diabet duke siguruar krijimin dhe miratimin e Planeve të Seksionit 504 më gjithëpërfshirëse, që përshkruajnë kujdesin dhe akomodimet e lidhura me diabetin që nxënësit me diabet kanë nevojë për të ndjekur shkollën në mënyrë të sigurt dhe për të përfituar nga arsimi dhe aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla; 2) trajnimin e infermierëve të shkollës, paraprofesionistëve, mësuesve dhe stafit tjetër të shkollës, shoferëve të autobusëve dhe shoqëruesve të autobusëve mbi kujdesin për diabetin për të përmbushur nevojat e nxënësve me diabet; 3) sigurimin që kujdesi dhe akomodimet e lidhura me diabetin të ofrohen në mjedisin më pak kufizues për të lejuar nxënësin të ndërveprojë sa më shumë të jetë e mundur me bashkëmoshatarët e tij pa aftësi të kufizuara, me synim kufizimin e humbjes së kohës mësimore dhe ndarjes nga shokët e klasës; dhe 4) sigurimin që nxënësit me diabet të kenë qasje të barabartë në shkollë dhe aktivitetet e lidhura me shkollën si ekskursionet, aktivitetet pas-shkollore dhe jashtëshkollore të sponsorizuara nga shkolla, dhe një program mëngjesi të njohur, duke kërkuar që ata të marrin kujdesin dhe akomodimet e nevojshme të lidhura me diabetin gjatë këtyre aktiviteteve.

**PËR TË MËSUAR MË SHUMË, OSE PËR TË MARRË NJË KOPJE TË PLOTË TË
NJOFTIMIT OSE MARRËVESHJES, VIZITONI DRALEGAL.ORG, DËRGONI EMAIL
TE DIABETESLAWSUIT@DRALEGAL.ORG, OSE TELEFONONI (332) 217-2362.**